



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Në bazë të nenit 17 pika 2 i Ligjit nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia e Drejtësisë me 17 prill 2018 shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Përkthime 3, (shqip – serbisht dhe anasjelltas)

Numri i referencës: 02/16/DP-AD

I përgjigjet: Koordinatorit të Programit

Kodi punës: IN/140 SHM + 3

Pozita : Jo e Karrierës

Numri i vendeve të punës: 1 (një)

Paga Neto: 436.70 Euro

Ky konkurs financohet nga Agjencioni Gjerman për Bahkëpunim dhe Zhvillim “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)”

Qëllimi i vendit të punës:

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike për stafin Profesional të një njësie organizative në fushën kryesore të punës, për përkthimin e të gjitha materialeve, duke siguruar përkthim cilësor.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Përkthen me shkrim, me gojë dhe simultan për stafin profesional dhe drejtues dhe aktivitetet tjera të AD-së;
2. Kryen një numër të detyrave specifike të rëndësishme lidhur me përkthimin e materialeve, zakonisht duke vepruar me vetë-iniciativë;
3. Përgjegjës për afate dhe saktësinë e punës së vet;
4. Merr përgjegjësi lidhur me përkthimin e materialeve që kërkohen nga institucioni;
5. Është përgjegjës për përkthimin e dokumenteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të njëjtave;
6. Mbanë evidencën e saktë e të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, përfshirë përgatitjen e raporteve për tërë punën e kryer;
7. Shpreh gatishmëri për të komunikuar rezultatet e punës (raportet e përpiluara) kur ato kërkohen nga financuesi i pozitës.
8. Kryen edhe detyra tjera të punës në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Njohuritë,shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

1. Shkathtësi të shkëlqyera të njohjes së gjuhës gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim;
2. Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Serbe;
3. Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

- Diploma e Shkollës së mesme

Përvoja e Punës:

- Tre (3) vite përvojë pune

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Akademia e Drejtësisë mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja e emërimit:

Emërimi është me afat te caktuar (Gjashtë muaj nga data e rekrutimit).

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur tetë (8) ditë pas shpalljes në gazetata lokale dhe në web faqen e Akademisë së Drejtësisë <https://ad.rks-gov.net>

Data e fundit e aplikimit është 25 prill 2018.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren në Akademinë e Drejtësisë, web faqe të Akademisë së Drejtësisë dhe dorëzohen në zyrat e Akademisë së Drejtësisë në Lagjen e Spitalit, Rr. “Muharrem Fejza” pa nr. Prishtinë, ose mund të dërgohen në email: burimenjerezore.ad@rks-gov.net

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmitë mbi përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kandidatët do të njoftohen me shkrim apo me telefon për datën e testit dhe intervistimit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (Vërtetimi dhe / ose kontrata e punës);
3. Dy rekomandime (nëse keni);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
5. Dokumentin e identifikimit – letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit (mbylljes së konkursit) nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Nëse ka numrër të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në Akademia e Drejtësisë në numrin e telefonit: 038 200 18 528, 038 200 18 661, prej orës 08:00 – 16:00.